



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 15 shtator 2022, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, AMA u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. “Pranimin e kërkesës së shoqërisë “AMG 2000” sh.p.k., për ndryshimin e kushteve teknike të licencës për transmetime audio analoge “Radio Alpo” duke reduktuar zonën e ofrimit të shërbimit nga “Qarku Gjirokastër”, në “*Bashkitë Gjirokastër, Libohovë dhe Dropull*”. (Vendimi nr. 94, datë 15.09.2022)
2. “Kalimin e të drejtave të autorizimit të shoqërisë “Elbasan Cable” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor Elbasan Cable”, tek shoqëria “Albanian Satellite Communications” sh.p.k.” (Vendimi nr. 95, datë 15.09.2022)
3. “Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Ardian Gega, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Mamurras”. (Vendimi nr. 96, datë 15.09.2022)
4. “Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Televizioni Kukës” sh.a., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Kukësi”. (Vendimi nr. 97, datë 15.09.2022)
5. “Dhënien e autorizimit, shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audiovizive me karakter të përgjithshëm, mbështetur në rrjet kabllor “Saranda TV”. (Vendimi nr. 98, datë 15.09.2022)
6. “Pranimin e kërkesës së shoqërisë “VODAFONE ALBANIA” sh.a., autorizuar për ofrimin dhe përsëritjen e shërbimeve audiovizive, për miratimin e disa ndryshimeve të paraqitura në kërkesën për marrjen e autorizimeve”. (Vendimi nr. 99, datë 15.09.2022)
7. “Kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca e subjektit person fizik Gëzim Brahusa, për shërbimin e programit audioviziv “Televizioni BS”, tek shoqëria “MEDIA BS” sh.p.k.” (Vendimi nr. 100, datë 15.09.2022).

AMA pasi u njoh me relacionin dhe projektvendimin “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të paraqitur nga subjekti person fizik Guri Meko, kundër vendimit nr. 6, datë 17.06.2022, vendosur ndaj subjektit OSHMA “TV me kabëll Aral”, ra dakord të shtyjë vendimmarrjen për një nga mbledhjet e tij vijuese.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 15 shtator 2022